



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Blerina Huruglica	11.01.2024	16.01.2024	2024/0035

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 09.01.2024, OE “NIKA PrO- Ing SH.P.K.”- Ferizaj, ka parashtruar ankesë me nr: **2024/0035**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Standard Beton SHPK & Arifaj Shpk” lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndertimi i QPD dhe QRA Ferizaj - vazhdim i punimeve” me nr. të prokurimit: “214-23-9615-5-1-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: **527,022.50€**.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së

Neni 6 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 72 i LPP-së.

Të nderuar ne me dt. 20.12.2023 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me vendimin e AK-së, ku e kanë rekomanduar për kontratë OE Standard Beton Sh.P.K & Arifaj Sh.P.K

Kemi kërkuar qasje dhe na është aprovuar dhe kemi arritur në përfundim se OE i rekomanduar për kontratë është i përgjegjshëm:

Edhe pas kërkesës për ri-shqyrtim ku e kanë vlerësuar si të PA BAZUAR ata prap e kanë rekomanduar OE e njëjtë i cili është në kundërshtim të plotë me kërkesat e FTD.

AK është dashtë që ta shpallë të përgjegjshëm OE Standard Beton shpk & Arifaj Shpk

Ne qasjen e OE të rekomanduar kemi verëjtur se OE është i pa përgjegjshëm në shumë pika:

Pretendimi 1. 3. Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i arkitekturës - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit, dhe deshmite e kërkuara Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali jo më e vjetër se 6 muaj nga data e publikimit të njoftimit për kontratë , CV, kontrata e punës valide ose marrëveshja e punës për këtë projekt me punëdhënësin dhe Letër referencë nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar-(Kopje).

Pika 1 OE ka ofruar kontratë me z. Shemsi Kelmendi të cilin kanë lidhur para kontratë me OE Standard Beton shpk, ku ceket se inxhinieri i lartepërmendur i cili është arkitekt do të kryej detyrat si inxhinier i makinerisë do të thotë se nuk e ka parakontratë për të angazhuar si arkitekt. Kjo kërkesë nuk plotësohet sipas FTD.

"STANDARD BETON " sh.p.k dhe Shemsi Kelmendi


Shemsi Kelmendi, lidhin parakontratë në fushën Inxhinier i Diplomuar i ARKITEKTURËS Lidhur me tenderin : Titulli: **Ndërtimi i QPD dhe QRA Ferizaj - vazhdim i punimeve 214-23-9615-5-1-1 , i shpallur nga MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME, "STANDARD BETON " sh.p.k** deklaroi se nëse në jemi fitues të kontratës, do të jetë vazhdimisht i angazhuar deri në përfundimin e kontratës si Inxhinier i Makinerisë

Pika 2. Diploma e kërkuar që të jetë e noterizuar 6 muaj nga data e publikimit të njoftimit edhe këto kërkesë OE nuk ka arritur ta plotësojë pasi ka ofruar diplome të noterizuar me dt. 23.07.2019.


Ky akt lëshohet në bevert. Tarifa është paguar sipas U.A mbi tarifën e përkohshme noteriale për çdo fletë nga
1€x7+18%TVSH=8.26 (tete euro e 26/100).....
Lipjan me datën 23.07.2019 (nëzet e tre korrik dymijë e nëntëmbëdhjetë).....

Pretendimi 2.7.Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i Elektronikës drejtimi automatik - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit. Dhe deshmite e kërkuara 7. Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali jo më e vjetër se 6 muaj nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, CV, kontrata e punës valide ose marrëveshja e punës për këtë projekt me punëdhënësin dhe Letër referencë nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar-(Kopje).

Pika 1. OE ka ofruar kontrate me z. Sami Hysenaj, e ka parakontrate per inxhiner te Elektroteknikes mirepo i njejt i nuk e ploteson kerkesen e FTD qe duhet te jete drejtimi Automatike. OE ne kete pike eshte i papergjegjshem.



Pika 2. Z. Sami Hysenaj ka ofruar: Diploma e kerkuar qe te jete e noterizuar 6 muaj nga data e publikimit te njoftimit edhe kete kerkese OE nuk ka arritutr ta plotesoje pasi ka ofruar diplome te noterizuar me dt. 15.11.2022



Pretendimi 3. Pajtohem me vendimin e kerkeses per ri-shqyrtim te Rasim Mjekiqit per noterizim.

Pretendimi 4. Z. Bledar Mihaj ka te noterizuar diplomen me dt 31.01.2023 me nr rendor 1619 dhe e ka te njejtin me nennshkrim e vule e te gjitha te tjerat me dt 31.07.2023 qe shifet qarte se

eshte edituare edhe eshte nr rendor i njejt 1619

Pretendimi 5. Z. Myzejen Papa ka te noterizuar diplomen me dt 31.01.2023 me nr rendor 1615 dhe e ka te njejtin me nennshkrim e vule e te gjitha te tjerat me dt 31.07.2023 qe shifet qarte se eshte edituare edhe eshte nr rendor i njejt 1615

Pretendimi 6. Grupi i OE i rekomanduar per kontrate ka bere ndryshime ne paramase ne kundershtim te plote me ligjin e LPP-se, UPP nr. 001/2023 dhe RRPP Nr. 001/2022

Grupi i OE ka nderhyre ne paramase duke ndryshuar **SASINË** ne paramase tek Punët e Instalimeve.

Ne FTD , sasia ne paramase eshte 0.40% ndersa Grupi i OE ka bere nderhyrje ne paramase duke e zvogeluar ne 0.04% me ç’rast eshte ne kundershtim te plote me ligjin

Shih me poshte paramasen pa nderhyrje !

2	Fitingje per instalimin e sistemit gypor per furnizim te uje te ngrohet dhe ftohet si dhe elementet mbajtse dhe shtanguese, kthesat, reduktuesit, mbajtës, teli, gazi për saldime, flanxhed, dado, bulona etj) 40% nga pozicioni 1	%	0.40	-	-
---	--	---	------	---	---

Paramasa me nderhyrje !

2	Fitingje per instalimin e sistemit gypor per furnizim te uje te ngrohet dhe ftohet si dhe elementet mbajtse dhe shtanguese, kthesat, reduktuesit, mbajtës, teli, gazi për saldime, flanxhed, dado, bulona etj) 40% nga pozicioni 1	%	0.04	4,488.60	179.54
---	--	---	------	----------	--------

Pra Grupi i OE te rekomanduar per kontrate ka bere nderhyrje dhe ndryshime me qellim duke ndryshuar paramasen e AK. Paramasa e cila eshte e njejte per te gjithe tenderuesit.

Poashtu rregullorja Nr. 001/2022 pika 40.10 thote;

b. *Nese ka mosperputhje mes cmimit total ne Formularin e Tenderit dhe totalit ne pershkrim te cmimeve, oferta refuzohet.* Prandaj oferta e OE fitues ka paperthueshmeri te cmimit mes formularit te tenderit dhe totalit ne pershkrimin e cmimit pas korrigjimit.

Pra kjo oferte duhet te vleresohet si e papergjegjshme.

Pretendimi 7. OE eshte i papergjegjshem pasi deklarata e veqanta nuk i ka, njashtu qe me krijimin e grupit OE eshte i papergjegjshem.

Lidhur me eliminimin tone ky konstatim i AK nuk qendron pasi jemi oferte e pergjegjshme dhe me letren per sqarim te kerkuar nga AK ju kemi pergjigjur ne afatin kohor.

Pretendimi 8. Qendrimi i AK- se lidhur me eliminimin tone nuk qendron pasi ne kemi krijuar grupin e koncensiumit dhe kemi arrit qe te plotesojme te gjitha kerkesat sipas LPP-se dhe ka qene nje gabim teknik qe ne dorezimin e ofertes nuk e kemi krijuar koncensiumin ne e-prokurim, mirepo te gjitha dokumentet e kerkuara jane ne dosjen e tenderit qe e kemi dorezuar.

Prentendimi 8. per Inxhinier i diplomuar ose Master i Elektroteknikes drejtimi automatike min 3 vite pervoje pune dhe Inxh. I diplomuar ose Master i Emergjencave min3 vite pervoje pune ne i kemi pasur ne listen e stafit profesional mirepo me gabim teknik nuk i kemi ngarkuar.

Ne Leter per sqarim nga ana e AK-se ne ju kemi pergjigj dhe kemi offuar gjithë dokumentacionin e kerkuar. AK e ka cekur se kontratat a po marreveshjet per kete projekt nuk kane date kur jane nenshkru, eshte shume e lehte te verifikohet kjo pasi personat kane E-mail adresa kane dhe nr telefoni, pasi qe AK kane dyshuar ne dokumentacionin tone eshte lehte e verifikueshme.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët** siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-së, sepse e kane rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik të papergjegjshem.

Gjithashtu AK nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi por po shihet se qëllimi i tyre është që ne mos të shpallemi fitues të këtij tenderi. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo AK nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Po ashtu AK nuk e ka respektuar edhe nenin 6 të LPP-së edhe pse autoritetet kontraktuese janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Në fund kërkojmë nga ju si OSHP që të nxjerrni:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE Nika Proing & Pro Co Group Sh.P.K. per tenderin: “ **Ndërtimi i QPD dhe QRA Ferizaj - vazhdim i punimeve**”

ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhe lënda kthehet në

RIVLERESIM dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

KRITERET PËR VLERËSIM


III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
<p>1. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të ofrojë dëshmi së ka përfunduar me sukses projekte në lëmin e ndërtimit të lartë dhe renovimeve të objekteve të larta nga (Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare) në vlerë prej të gjitha së bashku jo më pak se 700,000.00 Euro.</p>	<p>1. Lista e projekteve të përfunduara e nënshkruar dhe vulosur nga OE për projekte e realizuara, duke bashkëngjitur referenca ose procesverbalet e pranimit përfundimtar të punëve duke treguar vlerën, datën dhe vendin e realizimit të projektit.</p>
<p>2. OE duhet të paraqes Një (1) Menaxher të projektit i cili duhet të jetë Inxhinier i Diplomuar ose Master i Ndërtimtarisë drejtimi - konstruktiv ose Inxhinier i Diplomuar ose Master i arkitekturës - min. 5 vjet përvojë punë pas diplomimit dhe përvojë në menaxhimin e projekteve në ndërtim të lartë sepaku 1 projekt të përfunduara.</p>	<p>1. Për menaxherin e Projektit të paraqiten Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali jo me e vjetër së 6 muaj nga data e njoftimit për kontratë , CV , kontratae e punës valide ose marrëveshja e punës me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Vendim për caktimin e menaxherit të projektit i nënshkruar dhe vulosur nga punëdhënësi, Letër referencë nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar–(Kopje).</p>
<p>3. Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i arkitekturës - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.</p>	<p>3. Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali jo me e vjetër së 6 muaj nga data e publikimit të njoftimit për kontratë , CV, kontrata e punës valide ose marrëveshja e punës për këtë projekt me punëdhënësin dhe Letër referencë nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar–(Kopje).</p>
<p>4. Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i Ndërtimtarisë drejtimi Konstruktiv - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.</p>	<p>4. Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali jo me e vjetër së 6 muaj nga data e publikimit të njoftimit për kontratë , CV, kontrata e punës valide ose marrëveshja e punës për këtë projekt me punëdhënësin dhe Letër referencë nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar–(Kopje).</p>
<p>5. Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i Ndërtimtarisë drejtimi Hidro - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.</p>	<p>5. Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali jo me e vjetër së 6 muaj nga data e publikimit të njoftimit për kontratë , CV,</p>

	kontrata e punës valide ose marrëveshja e punës për këtë projekt me punëdhënësin dhe Letër referencë nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar–(Kopje).
6. Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i Ndërtimtarisë drejtimi Makineri - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.	6. Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali jo me e vjetër së 6 muaj nga data e publikimit të njoftimit për kontratë , CV, kontrata e punës valide ose marrëveshja e punës për këtë projekt me punëdhënësin dhe Letër referencë nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar–(Kopje).
7. Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i Elektronikës drejtimi automatik - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.	7. Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali jo me e vjetër së 6 muaj nga data e publikimit të njoftimit për kontratë , CV, kontrata e punës valide ose marrëveshja e punës për këtë projekt me punëdhënësin dhe Letër referencë nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar–(Kopje).
8. Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i Gjeodezisë - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.	8. Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali jo me e vjetër së 6 muaj nga data e publikimit të njoftimit për kontratë , CV, kontrata e punës valide ose marrëveshja e punës për këtë projekt me punëdhënësin dhe Letër referencë nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar–(Kopje).
9. Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i Emergjencave - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.	9. Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali jo me e vjetër së 6 muaj nga data e publikimit të njoftimit për kontratë , CV, kontrata e punës valide ose marrëveshja e punës për këtë projekt me punëdhënësin dhe Letër referencë nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar–(Kopje).

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

--

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "NIKA PrO- Ing SH.P.K.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i QPD dhe QRA Ferizaj - vazhdim i punimeve" me numër të prokurimit: "214-23-9615-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME


Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Puneve te Brendshme-Ministarstvo Unutrasnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs
Departamenti i Prokurimit / Departman za Javnu Nabavku / Department of Procurement

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES¹
Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: "Ndërtimi i QPD dhe QRA Ferizaj - vazhdim i punimeve"

Nr. i prokurimit	214-23-9615-5-1-1
-------------------------	-------------------

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertave
1.	" Kompania Prishtina " Sh.p.k, SELMAN RIZA NR.10, 10000, PRISHTINË, Kosovë	512,222.00€
2.	Olti Trasing SH.P.K., Bill Clinton, 10000, PRISHTINE, Kosovë	494,000.00€
<u>3.</u>	NIKA PrO- Ing SH.P.K., Rr.Rexhep Bislimi, 70000, Ferizaj, Kosovë	488,950.20€
<u>4.</u>	Grup i Operatorëve Ekonomik STANDARD BETON SH.P.K.; Arifaj.shpk, Dardani ,Rr.Beslidhja Nr.66, 10000, Prishtine, Kosovë	Në hapje 466,601.87€ pas korrigjimit 468,772.77€.

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Ministria e Punëve të Brendshme shpërblen me kontratë Grup i Operatorëve Ekonomik STANDARD BETON SH.P.K. & Arifaj.shpk, Dardani ,Rr.Beslidhja Nr.66, 10000, Prishtinë, Kosovë në vlerë të ofertës pas korrigjimit të gabimeve aritmetikore prej 468,772.77€.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - NIKA PrO- Ing SH.P.K.

Aktiviteti i prokurimit me titull:“ **Ndërtimi i QPD dhe QRA Ferizaj - vazhdim i punimeve**”me nr. të prokurimit: "**214-23-9615-5-1-1**", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME, ka filluar me njoftimin për kontrate me datë 21.09.2023, hapja e ofertave është bere me date 03.11.2023, si dhe njoftimi mbi vendimin B58 te AK është publikuar me date 20.12.2023. OE ankuesi i pa kënaqur me vendimin B58 të Ak-së, atëherë parashtron kërkesë për rishqyrtim pranë AK-se, ku ky i fundit ia refuzon kërkesën si të pa bazuar, dhe si e tillë OE ankuesi i pa kënaqur me refuzimin me date 05.01.2023 parashtron ankese ne OSHP.

Tutje, OE ankuesi i pakënaqur me rezultatet, dhe me arsyen e eliminimit te tij, ka parashtruar në ankesë pretendime kundër Grupit te operatoreve ekonomik (GOE) te rekomanduarit si dhe kundër arsyeve të eliminimit të tyre.

Pretendimet e OE ankues kundër GOE te rekomanduarit:

AK është dashtë që ta shpallë të pa përgjegjshëm OE Standard Beton Shpk & Arifaj Shpk

Ne qasjen e OE te rekomanduar kemi vërejtur se OE është i pa pergjegjshem ne shume pika:

Pretendimi 1. 3. Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i arkitekturës - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit, dhe deshmite e kerkuara Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali jo me e vjetër së 6 muaj nga data e publikimit të njoftimit për kontratë , CV, kontrata e punës valide ose marrëveshja e punës për këtë projekt me punëdhënësin dhe Lctër referencë nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar-(Kopje).

Pika 1 OE ka ofruar kontrate me z. Shemsi Kelmendi te cilin kane lidhur para kontrate me OE Standard Beton Shpk, ku ceket se inxhinieri i lartepemendur i cili është arkitekt do ti kryej detyrat si inxhinier i makinerise do te thote se nuk e ka parakontrate per tu angazhuar si arkitekt. Kjo kerkese nuk plotesohet sipas FTD.

“STANDARD BETON ” sh.p.k dhe Shemsi Kelmendi

Shemsi Kelmendi, lidhin parakontratë ne fushen Inxhinier i Diplomuar i ARKITEKTURES Lidhur me tenderin : Titulli: **Ndërtimi i QPD dhe QRA Ferizaj - vazhdim i punimeve 214-23-9615-5-1-1** , i shpallur nga **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**, “STANDARD BETON " sh.p.k deklaroi se nëse ne jemi fitues të kontratës, do të jetë vazhdimisht i angazhuar deri në perfundimin e kontratës si Ingjinier i **Makineris**

Pika 2. Diploma e kerkuar qe te jete e noterizuar 6 muaj nga data e publikimit te njoftimit

edhe kete kerkese OE nuk ka arritur ta plotesoj pasi ka ofruar diplome te noterizuar me dt. 23.07.2019.

Pergjigje ne pretendimet e GOE ankues kundër GOE te rekomanduarit:

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e OE ankues sqaron se, ne ofertën e GOE te rekomanduarit gjendet ing. i arkitekturës z.SH.K ku ne oferte ka te bashkangjitur nje parakontrate ne te cilën ceket se pozita e punës do te jete inxhinier i makinerisë ndërsa kualifikimi i tij është Arkitekt me diplomë, dhe si e tille **pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

Kurse sa i përket pikës 2 te OE ankues lidhur me noterizimin, I njëjti ka të noterizuar diplomën me datë 23.07.2019 pra më tepër se 6 muaj, si e tille **pretendimi gjendet i bazuar.**

Pretendimi 2.

Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i Elektronikës drejtimi automatik - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit. Dhe deshmite e kerkuara 7. Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali jo me e vjetër së 6 muaj nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, CV, kontrata c punës valide ose marrëveshja e punës për këtë projekt me punëdhënësin dhe Letër referencë nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar-(Kopje).

Pika 1. OE ka ofruar kontrate me z. Sami Hysenaj, e ka parakontrate per inxhinier te Elektroteknikes mirepo i njejti nuk e ploteson kerkesen e FTD qe duhet te jete drejtimi Automatike. OE ne kete pike eshte i papergjegjshem.

Pika 2. Z. Sami Hysenaj ka ofruar: Diploma e kerkuar qe te jete e noterizuar 6 muaj nga data e publikimit te njoftimit edhe kete kerkese OE nuk ka arritur ta plotesoj pasi ka ofruar diplome te noterizuar me dt. 15.11.2022

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e OE ankues sqaron se, ne ofertën e GOE te rekomanduarit gjendet inxhinieri i diplomuar i elektroteknikes drejtimi elektroenergjetikë industriale z.S.H, kurse ne kërkesën e AK-se kërkohet inxhinier drejtimi Automatik, dhe si e tille **pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

Sa i përket pikës nr 2 sqarojme se i njëjti ka të noterizuar diplomën me datë 15.11.2022 pra më tepër se 6 muaj, si e tille **pretendimi gjendet i bazuar.**

Pretendimi 3. Pajtohem me vendimin e kerkeses per ri-shqyrtim te Rasim Mjekiqit per noterizim.

Ekspertja Shqyrtuesepretendimin e 3 nuk ka nevojte ta sqaroj, për faktin se OE është pajtuar.

Pretendimi 4. Z. Bledar Mihaj ka te noterizuar diplomën me dt 31.01.2023 me nr rendor 1619 dhe e ka te njejtin me nenshkrim e vule e te gjitha te tjerat me dt 31.07.2023 qe shifet qarte se eshte edituare edhe eshte nr rendor i njejt 1619.

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e 4 sqaron se, ne ofertën e GOE te rekomanduarit gjendet ing.z.B.M me diplome e cila është e noterizuar në Shqipëri, ku në noterizim nuk ka asnjë numr i cili e identifikon që noterizimi ka të bëjë me të njëjtën diplome, po ashtu pas kërkesave të AK-së për sqarim, OE i rekomanduar ka bashkangjitur noterizimet të cilat tani ndryshojnë datat në noterizim ndërsa numri rendor nuk ndryshon, andaj si e tillë konsideroj se AK duhet ta sqaroj të njëjtën, për faktin se paraqesin ndryshim material dokumentet shtesë, si e tille**pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar**

Pretendimi 5. Z. Myzejen Papa ka te noterizuar diplomën me dt 31.01.2023 me nr rendor 1615 dhe e ka te njëjtin me nennshkrim e vule e te gjitha te tjerat me dt 31.07.2023 qe shifet qarte se eshte edituare edhe eshte nr rendor i njejt 1615.

Ekspertja Shqyrtuese lidhur mepretendimin e 5 sqaron se, ne ofertën e GOE te rekomanduarit gjendet ing.z.M.P me diplome e cila është e noterizuar në Shqipëri, ku në noterizim nuk ka asnjë numr i cili e identifikon që noterizimi ka të bëjë me të njëjtën diplomë, andaj si e tille konsideroj se AK duhet ta sqaroj te njëjtën, për faktin se paraqesin ndryshim material dokumentet shtesë, si e tillëpretendimi i OE ankues gjendet i bazuar

Pretendimi 6. Grupi i OE i rekomanduar për kontrate ka bere ndryshime ne paramase ne kundërshtim te plote me ligjin e LPP-se, UPP nr. 001/2023 dhe RRPP Nr. 001/2022

Grupi i OE ka ndërhyrë ne paramase duke ndryshuar SASINË ne paramase tek Punët e Instalimeve.

Ne FTD , sasia ne paramase eshte 0.40% ndersa Grupi i OE ka bere nderhyrje ne paramase duke e zvogeluar ne 0.04% me ç’rast eshte ne kundërshtim te plote me ligjin

Ekspertja Shqyrtuese lidhur mepretendimin e 6 sqaron se, ne ofertën e GOE te rekomanduarit gjendet paramasa ne PDF e cila siç pretendon edhe OE ankuesi, ka ndërhyrje tek pika 2 ne paramase, për faktin se paramasa e standardizuar e AK-se ne E-prokurim ka te kalkuluar sasitë dhe përqindjen, dhe si e tillë nuk duhet te ndryshohen përmbajtjet e qelizave, andaj pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.

Pretendimi 7. OE eshte i papergjegjshem pasi deklaratat e veqanta nuk i ka, njashtu qe me krijimin e grupit OE eshte i papergjegjshem.

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e 7 sqaron se, ne ofertën e GOE te rekomanduarit gjendet marrëveshja e bashkëpunimit, e cila i ka te përfshira 3 pikat me një marrëveshje, dhe si e tille konform rregullores për prokurim publik nr 001/2022 neni 26, pretendimi i OE ankues nuk gjendet i bazuar.

26.2 Deklaratat e kërkuara në (a), (b) dhe (c) të paragrafit 26.1, mund të përfshihen në një dokument.

Pretendimet e OE ankues kundër eliminimit nga AK:

Lidhur me eliminimin tone ky konstatim i AK nuk qëndron pasi jemi oferte e përgjegjshme dhe me letrën për sqarim te kërkuar nga AK ju kemi përgjigjur ne afatin kohor.

Pretendimi 8. Qendrimi i AK- se lidhur me eliminimin tone nuk qendron pasi ne kemi krijuar grupin e koncerciumit dhe kemi arrit qe te plotesojme te gjitha kerkesat sipas LPP-se dhe ka qene nje gabim teknik qe ne dorezimin e ofertes nuk e kemi krijuar koncerciumin ne e-prokurim, mirepo te gjitha dokumentet e kerkuara jane ne dosjen e tenderit qe e kemi dorezuar.3

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e 8 sqaron se, OE ankues në ofertë ka të bashkangjitur deklaratat e konzorciumit, deklaratat nën betim, dokumentet e biznesit për dy operatorët në konzorcium, që vërehet se i njëjti aplikon si konzorcium, mirëpo gjatë aplikimit në e-prokurim ka bërë gabim teknik gjatë aplikimit, ku në formularin e gjeneruar nga sistemi nuk ka të shtuar anëtarin e konzorciumit, gjerësa tek pjesa Formular për dorëzim të tenderit gjenden të gjitha informatat lidhur me titullin e aktivitetit të prokurimit, numrin e prokurimit, çmimin e ofertës, atëherë si e tillë, meqenëse në

LPP pjesa teknike e E-prokurimit nuk specifikohet si e tillë konsideroj se AK në rivlerësim duhet të sqarohet me KRPP-në lidhur me gabimet teknike të procesuara në E-prokurim.

Prentendimi 8. per Inxhinier i diplomuar ose Master i Elektroteknikes drejtimi automatike min 3 vite pervoje pune dhe Inxh. I diplomuar ose Master i Emergjencave min 3 vite pervoje pune ne i kemi pasur ne listen e stafit profesional mirepo me gabim teknik nuk i kemi ngarkuar.

Ne Leter per sqarim nga ana e AK-se ne ju kemi pergjigj dhe kemi offuar gjithe dokumentacionin e kerkuar. AK e ka cekur se kontratat a po marreveshjet per kete projekt nuk kane date kur jane nenshkru, eshte shume e lehte te verifikohet kjo pasi personat kane E-mail adresa kane dhe nr telefoni, pasi qe AK kane dyshuar ne dokumentacionin tone eshte lehte e verifikueshme.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët** siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-së, sepse e kane rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik të papergjegjshem.

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me arsyen e eliminimit për inxhinierët të elektroteknikes dhe ing. Master i Emergjencave, sqarojmë se, AK ka kërkuar sqarime, për të cilat OE ankues i ka bashkangjitur të gjitha dokumentet konform kërkesës së AK-së, të cilat konsideroj mund të merren të mirëqenë, konform nenit 72 të LPP-së, për faktin se në ofertë para hapjes, OE në listën e stafit ka të specifikuar emrat e inxhinierëve.

Kurse sa i përket arsyes së AK-së lidhur me Inxhinierin e Emergjencave, qartësojmë se, AK në DT ka kërkuar:

9. Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i Emergjencave - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.

9. Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali jo me e vjetër së 6 muaj nga data e publikimit të njoftimit për kontratë , CV, kontrata e punës valide ose marrëveshja e punës për këtë projekt me punëdhënësin dhe Letër referencë nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar–(Kopje).

Pra, në rastin konkret lidhur me këtë kërkesë, AK ka kërkuar çfarëdo dokumenti që e dëshmon përvojën e punës, për arsye se kjo pozitë është më specifike, andaj gjatë rivlerësimit mund të kërkohet dëshmi/sqarim shtesë të cilat e sqarojnë referencën e bashkangjitur.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “NIKA PrO- Ing SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i QPD dhe QRA Ferizaj - vazhdim i punimeve” me numër të prokurimit: “214-23-9615-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **NIKA PrO- Ing SH.P.K.**



Blerina Huruglica